



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 2526/2020  
Data: 12.04.2020

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e katërt -IV- për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 17.03.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkyetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Financa), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-mars 2020.
3. Shqyrtimi i raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
4. Shqyrtimi i informatës për ndarjen e bursave.
5. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiarë për tre mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## 2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-mars 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- të hyrat vetanake për këtë periudhe tremujore 2020 janë realizuar në shumë prej 47,683.24 € apo për 3,094.97 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2019. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-mars 2020 është në shumë prej 494,651.38 € apo 18.04 % dhe atë paga dhe mëditje janë shpenzuar 371,118.56 € apo 21.99 %, në mallra dhe shërbime 48,212.74 € apo 15.90 %, në shpenzime komunale 10,557.18 € apo 17.60 %, në subvencione dhe transfere 4,600.00 € apo 7.53% dhe në shpenzime kapitale 60,162.90 € apo 9.55 %. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket shpenzimeve te secila kategori janë rritur duke filluar te pagat dhe mëditjet , mallrat dhe shërbimet dhe e njëjta është edhe te kategoritë e tjera. Kërkoj sqarim se cila është arsyeja e rritjes së këtyre shpenzimeve

**Shabi Rexhallari** thekson:- te pagat dhe mëditjet janë rritur 1.9 % për shkak se në muajin mars me vendim të qeverisë zjarrëfiksit janë paguar nga 960 .00 € e që për gjashtë persona janë shpenzuar 6048.00 € .

**Mehmet Ballazhi** thekson:-këto mjete shtesë që janë dhënë a është dashur patjetër prej komunës me i marr apo duhet të bëhet ndonjë kërkesë shtesë.

**Shabi Rexhallari** thekson:-me vendim të qeverisë është ekzekutuar prej komunës nga kategoria paga dhe mëditje. Te mallrat dhe shërbimet ishin 36 000.00 € mjete financiare të pa paguara nga viti i kaluar dhe tash janë iniciuar procedurat dhe për këtë arsye shpenzimet janë më të mëdha. Te shpenzimet komunale nuk ka pasur ndonjë diferencë të madhe. Te subvencionet kemi më pak shpenzime , ndërsa te investimet kapitale projekti i shtëpisë së kulturës është projekt dy vjeçar dhe këto janë ata që e kanë bërë këtë rritje dhe nuk ka pasur diçka tjetër.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mirë këto sqarime që u potencuan me i paraqitë në kllapa pasi që ka arsyeshmëri.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.**

## 3. Shqyrtimi i raportit periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- siç e dimë kemi pasur rekomandime nga viti i kaluar e jemi mundur dhe kemi pasur planin për plotësimin e tyre . Janë disa pika që pjesërisht i kemi kryer dhe është pika e investimeve të mallrave nën njëmijë euro dhe mbi dy mijë euro e që kemi pasur probleme për caktimin e vlerave të mallrave të cilat kanë ardhur paraprakisht për shkak se secilin mall që e kemi duhet me pasur vlerën e atij malli. Kryesisht kemi pasur problem me shkollat dhe ambulantë, e i kemi realizuar pjesërisht dhe po ashtu edhe të hyrat i kemi pjesërisht. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.



**Mehmet Ballazhi** thekson:- shtylla e rekomandimeve që janë të zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara nuk po e di se sa janë zbatuar këto rekomandime për shkak se shënon pjesërisht të zbatuara dhe kjo është ndoshta në përqindje, është mirë të kemi ndonjë sqarim më të detajuar sa i përket rekomandimeve.

**Mallzum Qajani** thekson:- te pika dy sfidë mbetet të ceket inkasimi i borxheve të bizneseve që janë pasiv që do të thotë se janë bizneset të cilat nuk e kanë paguar taksën komunale dhe e kanë shuar veprimtarinë dhe kemi probleme sepse nuk mund ta gjejmë adresën por kur e shuajnë biznesin nuk vijnë me shuar edhe në komunë. Ka raste që ata e kanë shuar veprimtarinë në Administratën Tatimore të Kosovës por nuk e kanë shuar në komunë dhe për atë i kemi këto probleme. Çështja e menaxhimit të dobët të pasurive jo financiare është se e tërë pasuri që është duhet t'i përcaktohet vlera dhe komisioni është munduar me kryer ato punë por nuk ka mundur për arsye se duhet të ketë dëshmi që e ka këtë vlerë. Mungesa e mekanizmave për inkasimin e të arkëtueshmeve dhe unë potencova që për një pjesë nuk kemi mundur me gjetur adresën, me një pjesë kemi lidhur kontratë mirëpo koronavirusit i ka dobësuar krejt. Mungesa e themelimin të NJAB-së neve nuk na takon me bërë sepse e kemi buxhetin nën tre milionë euro.

**Teuta Shkreta** thekson:- personat të cilët dërgohen në përmbaues a njoftohen paraprakisht.

**Mallzum Qajani** thekson:- të gjithë personat njoftohen dhe nëse ata nuk lidhin kontratë me komunën për me i kryer obligimet atëherë dërgohen në përmbaues.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA RAPORTI PERIODIK LIDHUR ME PROGRESIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **4. Shqyrtimi i informatës për ndarjen e bursave.**

**Kryesuesi** thekson:- drejtori i drejtorisë për arsim për shkak të angazhimeve që i ka nuk mundi të jetë prezent në mbledhja por na shpjegoi për këtë pikë të rendit të punës. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA INFORMATA PËR NDARJEN E BURSIVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **5. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiarë për tre mujorin e N.P.L "Pastrimi" sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Teuta Shkreta** thekson:- propozoj që për punëtorët e kompanisë të ndajmë mjete financiare në mënyrë që t'i shpërblejmë në mënyrë simbolike për punën që e kanë bërë. A dërgohen në përmbaues personat të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj kësaj kompanie.

**Mallzum Qajani** thekson:-përveç atyre personave që janë dërguar më herët tjerë nuk janë dërguar, mirëpo para periudhës së koronavirusit inkasimi nuk ka qenë keq dhe informata që shtyhen këto pagesa e ka dërguar një inkasim zero por kanë filluar pagesat. Është një kategori e punëtorëve që merren me mbeturinat të cilin i marrin edhe te familjet e prekura nga koronavirusi por ndoshta do të përfshihen përmes pakos së qeverisë.

**U VOTUA INFORMATA MBI RAPORTIN FINACIARË PËR TRE MUJORIN E NPL PASTRIMI SH.A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## 6. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për mbledhje të kuvendit të komunës do të përcjellim edhe pikat të cilat ishin të planifikuara për muajin mars. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:34

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**

